




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-12830/24 datë:22.04.2024



Npi – 01/183 datë: 29.05.2024

Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna; Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave; Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes shqyrtoi rekomanimin e MAPL-së, Nr.0-183-10 të datës 13.05.2024 për Rishqyrtimin e Vendimit për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2024-2028 Npi-01-80 të datës 26.02.2024, si dhe duke marrë parasysh Rekomandimin e KPF-së, Npi – 01/171 të datës:27.05.2024, Kuvendi në seancën e mbajtur më 29.05.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR NDRYSHIMIN E BAZËS LIGJORE TË VENDIMIT ME NUMËR
Npi-01/80 TË DATËS 26.02.2024**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në Seancën e -V- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 29.05.2024, me shumicën e votave miratoi vendimin për ndryshimin e bazës ligjore të vendimit me numër Npi-01/80 të datës 26.02.2024 për miratimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale për periudhën 2024-2028, dhe bëhet si vijon:

"Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna; Rregulloren e MAPL-së Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave; Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008".

II

A r s y e t i m: Në Vendimin e mëparshëm të Kuvendit me numër Npi-01/80 të miratuar më 26.02.2024, baza ligjore ka qenë si vijon: "Bazuar në nenin 12.2. shkronja (c), dhe nenin 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komuna; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Rregulloren e (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave; Si dhe duke u bazuar në nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008".

- Pas Rekomandimit të MAPL-së, Nr.0-183-10 të datës 13.05.2024 për Rishqyrtimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2024-2028, Kuvendi i Komunës së Shtimes mori vendim sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, për përmirësimin e bazës ligjore në vendimin me numër Npi-01/80 dhe në Planin e Veprimit për Transparencë Komunale 2024-2028, me numër Npi-01/81 të datës 26.02.2024.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi